



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.357/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Syla, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, Avdyl Krasniqi, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, Avdyl Krasniqi, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë ZL.A.nr.357/2017 të paraqitur me datë 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Avdyl Krasniqi, kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik PDK, me të cilën pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrën e Vendvotimit 0913e/01R në Komunën e Fushë Kosovës.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë ankesës, lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë përkitazi me manipulimin e votave në Qendrën e Vendvotimit 0913e/01R në Komunën e Fushë Kosovës, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Avdyl Krasniqi,

nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.357/2017 më datën 24.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.